



Funded by  
the European Union

# MANUAL PËR TRAJTIMIN E RASTEVE DPI

## DOGANA E KOSOVËS




**IPRproject**  
Intellectual Property Rights Project

A project implemented by:



Prishtinë, 2022



|   |    |
|---|----|
| <b>Tabela e përmbajtjes</b>                             | 5  |
| <b>Lista e shkurtesave</b>                              | 7  |
| <b>Hyrje</b>  | 8  |
| <b>1-Fushëveprimi i Ligjit Nr. 06/L-015</b>             | 9  |
| <b>1.1. Llojet e të drejtave të mbuluara</b>            | 9  |
| 1.1.1. Markat tregtare                                  | 10 |
| 1.1.2. Patentat   | 11 |
| 1.1.3. Dizajnet industriale                             | 11 |
| 1.1.4. E drejta e autorit ose të drejtat e përfaqësuara | 12 |
| 1.1.5. Treguesit gjeografik                             | 12 |
| 1.1.6. Emërtimi i origjinës                             | 12 |
| 1.1.7. Të drejtat e varietetit të bimës                 | 13 |
| 1.1.8. Topografia e Prodhimit të Gjysmëpërçuesve        | 13 |
| 1.1.9. Çertifikatat mbrojtjes shtesë                    | 13 |
| 1.1.10. Modelet e dobishme                              | 13 |
| 1.1.11. Emrat tregtarë                                  | 14 |
| <b>1.2. Llojet e të drejtave të mbuluara</b>            | 14 |
| 1.2. Parimet  | 14 |
| 1.2.2. Përjashtimet                                     | 15 |
| <b>1.3. Lëvizjet e Mallrave të Mbuluara</b>             | 16 |
| 1.3.1. Mbikëqyrja dhe Kontrolli Doganor                 | 16 |

|  |           |
|--|-----------|
| 1.3.2. Procedurat doganore   | 16        |
| <b>2-Aplikimi për veprim</b>   | <b>17</b> |
| <b>2.1. Personat me të drejtë që të kërkojnë veprim doganor</b>          | <b>17</b> |
| <b>2.2. Format standarde-përmbajtja e aplikacionit</b>                   | <b>17</b> |
| <b>2.3. Parashtrimi dhe aprovimi i aplikacioneve për veprim</b>          | <b>19</b> |
| <b>2.4. Zgjatja e periudhës së vlefshmërisë së kërkesës</b>              | <b>20</b> |
| <b>2.5. Ndryshimet e vendimeve për aprovim të kërkesës</b>               | <b>20</b> |
| <b>2.6. Pezullimi ose revokimi i vendimeve për aprovim të kesës</b>      | <b>20</b> |
| <b>3-Procedurat e parashikuara në Ligjin nr. 06/l-015</b>                | <b>21</b> |
| <b>3.1. Veprimi doganor</b>  | <b>21</b> |
| 3.1.1. Veprimi pas aplikimit   | 21        |
| 3.1.2. Veprimi sipas detyrës zyrtare                                     | 21        |
| 3.1.3. Veprimet pas parashtrimit dhe pranimit të një Aplikimi për Veprim | 22        |
| <b>3.2. Procedura e thjeshtuar e shkatërrimit</b>                        | <b>23</b> |
| <b>3.3. Procedura e thjeshtuar e shkatërrimit për dërgesa të vogla</b>   | <b>24</b> |
| <b>4 - Detyrimet dhe kostot</b>  | <b>26</b> |
| <b>4.1 Detyrimet e doganës së Kosovës</b>                                | <b>26</b> |

|   |    |
|---|----|
| <b>4.2 Detyrimet e mbajtësit të vendimit</b>                      | 26 |
| <b>4.3 Detyrimet për kostot</b>                                   | 26 |
| <b>5 - Çështjet tjera që lidhen me procedurat e zbatimit</b>      | 27 |
| <b>5.1 Lirimi i hershëm i mallrave</b>                            | 27 |
| <b>5.2. Treguesit e riskut për shkelje të pronës intelektuale</b> | 27 |
| 5.2.1. Treguesit e Riskut të Bazuar në Dokument                   | 28 |
| 5.2.2. Treguesit e Riskut të Bazuar në Paketim                    | 32 |
| 5.2.3. Treguesit e Riskut Bazuar në Mallra                        | 32 |
| <b>5.3. Mjetet e disponueshme për trajtimin e rasteve të DPI</b>  | 34 |

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**APV** - Aplikimi për veprim

**BE** - Bashkimi Evropian

**DPI** - Të Drejtat e Pronësisë Industriale

**Agjencia IP** - Agjencia e Pronësisë Industriale

**IIPCIC** - Kolegji Ndërkombëtar i Hetuesve të Krimin të Pronës Intelektuale

**MKRS** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

**OCCR** - Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

**OBD** - Organizata Botërore e Doganave

**WIPO** - Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

# HYRJE

Qëllimi i këtij manuali është të ndihmojë zyrtarët doganorë dhe operatorët tjerë ekonomikë në kuptimin dhe implementimin e procedurave sipas ligjit për masat doganore të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe për të promovuar një kuptim më të mirë të funksionimit të procedurës së aplikimit. Gjithashtu, ky manual do të garantojë një qasje të mirë dhe harmonizim të procedurave për aplikim/kërkesat për veprim nga Dogana, për mbrojtjen e pronës intelektuale, për trajtim të barabartë të mbajtësve të të drejtave në Kosovë. Zyrtarët e Doganave janë të autorizuar që të marrin masa kundër shkeljeve të të Drejtave të Pronës Intelektuale (DPI), procedurat që duhet të ndiqen e të cilat rregullohen nga:

- Kodi Doganor dhe i Akcizave nr. 03/L-109-2008
- Ligji Nr. 06/L-015/2018 për Masat Doganore për mbrojtjen e DPI
- Udhëzimi Administrativ nr. 053/2018.

Kështu, këto udhëzime japin një interpretim të përafërt të procedurës së aplikimit për mbrojtjen e pronës intelektuale nga autoritetet doganore, të cilat implementojnë masa doganore për ta luftuar falsifikimin dhe piraterinë.

Ky manual nuk është akt ligjor dhe nuk është i detyrueshëm, por ofron vetëm udhëzime dhe informata standarde për aplikimin e masave doganore për mallrat që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale dhe udhëzime mbi procedurën e aplikimit/kërkesës për veprim.

Ky manual do të përditësohet sa herë që dalin zhvillime të reja në legjislacion dhe në sistemin e aplikimeve për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Ky tekst jep udhëzime për stafin në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen kur vërehen mallra që dyshohet se shkelin një DPI.

## Manuali

- jep një përmbledhje të procesit të Aplikimit për Veprim (APV), nën të cilin mbajtësit e të drejtave PI mund të kërkojnë veprim doganor kundër shkeljeve të këtyre të drejtave.
- përcakton procedurën standarde të zbatimit.

- përshkruan *procedurën sipas detyrës zyrtare*, sipas së cilës disa mallra të dyshuara për shkelje të një DPI mund të ndalohen kur nuk është miratuar APV.
- adreson një procedurë të prezantuar nga Ligji nr. 06/L-015 për mallrat në dërgesat e vogla që dyshohen se shkelin një DPI
- adreson një numër të çështjeve tjera në lidhje me funksionimin e procesit për zbatimin e DPI-së.

Duhet të theksohet se procedurat e përshkuara në këto shënime mbulojnë gamën e plotë të veprimeve që mund të ndërmerren për ta zbatuar DPI.

Në përputhje me nenin 2.1, 2.2 dhe 2.3 të ligjit nr. 06/L-015, procedurat e zbatimit nuk aplikohen për:

- ✓ mallrat që janë lëshuar nën regjimin e përdorimit të fundit, dhe
- ✓ mallrat e natyrës jo komerciale në bagazhet personale të udhëtarëve

## 1. FUSHËVEPRIMI I LIGJIT NR. 06/ L-015

Më poshtë është lloji i të drejtave të mbuluara nga Ligji Nr. 06/L-015 për Masat Doganore për mbrojtjen e DPI.

### 1.1. LLOJET E TË DREJTAVE TË MBULUARA

Sipas përkufizimit, të Drejtat e Pronësisë Intelektuale duhet të kuptohen si lloje të caktuara të *të drejtat ekskluzive të kapitalit intelektual dhe krijimeve të mendjes*. DPI mbulon të gjitha format e veprimtarive komerciale dhe krijimeve artistike. Ato ndahen në dy kategori: pronë industriale dhe të drejtat e autorit. Prona industriale përfshinë një larmi të të drejtave si patentat, markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe dizajnet. E drejta e autorit i mbron veprat letrare dhe artistike (libra, drama, filma, vepra muzikore, piktura, fotografi, skulptura, harta etj.). E drejta e autorit gjithashtu përfshinë të drejtat e përafërta ose fqinje siç janë ato të performuesve, producentëve të filmave dhe regjistrimeve zanore dhe transmetuesve.

Agjencia e Pronësisë Industriale (Agjencia PI) brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të të drejtave të pronësisë industriale.

Zyra e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta (MKRS) është organ administrativ brenda Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) përgjegjës për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

### 1.1.1. Markat tregtare

Në Kosovë markat tregtare mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-026.

Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë e cila mund të përfaqësohet grafikisht, veçanërisht fjalët, duke përfshirë emrat personal, dizajnet, shkronjat, numrat, formën e mallrave ose paketimin e tyre, ngjyrat si dhe kombinimin e të gjitha më sipër me kusht që mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje mund të dallohet nga ndërmarrjet tjera.

#### Shembuj;

**Shenjat e fjalëve:** Michael Kors, Apple

**Shkurtesat:** BMW, IBM

**Sllloganet:** Just Do It

**Fjalë në formë figurative**



**Logot e pastra figurative**



**Kombinimi i fjalëve dhe logove figurative**





### 1.1.2. Patentat

Patentat mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-029.

Patenta është një e drejtë ekskluzive e dhënë për një shpikje, e cila është një produkt ose një proces që siguron, në përgjithësi, një mënyrë të re për të bërë diçka, ose ofron një zgjidhje të re teknike për një problem. Për ta marrë një patentë, informatat teknike në lidhje me shpikjen duhet të shpalosen për publikun në aplikacionin për patentë.

Patenta jepet për çdo shpikje, në çdo fushë të teknologjisë, që përbën risi, përfshin përparim inovativ dhe që është e zbatueshme në industri.

Në parim, pronari i patentës ka të drejtën ekskluzive për t'i parandaluar ose ndaluar të tjerët nga shfrytëzimi komercial i shpikjes së patentuar. Me fjalë tjera, mbrojtja e patentës do të thotë që shpikja nuk mund të bëhet, të përdoret, shpërndahet, importohet ose shitet komercialisht nga të tjerët pa pëlqimin e pronarit të patentës.

### 1.1.3. Dizajni industrial

Një dizajn industrial përbën aspektin zbukurues ose estetik të një artikulli. Një model mund të përbëhet nga tipare tre-dimensionale, si forma ose sipërfaqja e një artikulli, ose nga tiparet dy-dimensionale, si modelet, vijat ose ngjyrat.

Agjencia IP është përgjegjëse për procedurën e regjistrimit dhe mbrojtjen e modelit industrial në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-058.

Në parim, pronari i një dizajni industrial të regjistruar ose i një patente të dizajnit ka të drejtë të parandalojë palët e treta nga krijimi, shitja ose importimi i artikujve që mbajnë ose mishërojnë një dizajn që është kopje, ose në thelb një kopje, e dizajnit të mbrojtur, kur aktet e tilla ndërmerren për qëllime komerciale.

Dizajnet industriale aplikohen në një larmi të madhe të produkteve të industrisë dhe artizanatit: nga paketat dhe kontejnerët te mobilimi dhe mallrat shtëpiake, nga pajisjet e ndriçimit te bizhuteritë dhe nga pajisjet elektronike te tekstilet. Dizajnet industriale mund të jenë të rëndësishme për simbolet grafike, grafikat e përdoruesve që ndërveprojnë dhe logot.

#### 1.1.4. E drejta e autorit ose të drejtat e përafërta

E drejta e autorit (ose të drejtat e autorit) është një shprehje ligjore që përdoret për t'i përshkruar të drejtat që krijuesit kanë mbi veprat e tyre letrare dhe artistike. Punimet e mbuluara nga e drejta e kopjimit ndryshojnë nga librat, muzika, pikturat, skulpturat dhe filmat, deri te programet kompjuterike, bazat e të dhënave, reklammat, hartat dhe vizatimet teknike. Të drejtat e përafërta ose ato fqinje janë një grup i veçantë i të drejtave të tipit të kopjimit që u jepen personave ose organeve të caktuara që ndihmojnë në lansimin e veprave për publikun. Përfituesit e të drejtave të përafërta zakonisht janë performuesit, prodhuesit e fonogrameve dhe organizatat transmetuese.<sup>1</sup>

Mbrojtja e të drejtës së autorit fitohet automatikisht pa nevojën e regjistrimit ose formaliteteve tjera.

Legjislacioni për të drejtat e autorit në Kosovë përbëhet nga Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

#### 1.1.5. Treguesit gjeografik

Treguesi gjeografik është një term ligjor i përdorur për ta identifikuar një produkt me origjinë në një vend specifik (regjion ose shtet) cilësia, reputacioni ose karakteristikat tjera e të cilit i atribuohen në thelb origjinës së tij gjeografike. **Të paktën një** prej hapave të prodhimit të produktit krijohet në zonën e përcaktuar gjeografike.

Ligji Nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës e jep bazën ligjore për treguesit gjeografikë në Kosovë.

Djath Sharri, një produkt tradicional nga mallet e Sharrit është një shembull i mirë për Kosovë.

#### 1.1.6. Emërtimi i origjinës

Emërtimi i origjinës është një emër i përdorur për ta identifikuar një produkt si me origjinë në një vend specifik (rajon ose shtet) ku kufijtë gjeografikë janë në thelb ose ekskluzivisht për shkak të një mjedisi të veçantë gjeografik me faktorët e tij natyror dhe njerëzor.

---

<sup>1</sup> <https://www.wipo.int/copyright/en/>

**Të gjitha hapat** e prodhimit duhet të bëhen në zonën e përcaktuar gjeografike.

Ligji Nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës siguron bazën ligjore për emërtimet e origjinës në Kosovë.

### **1.1.7. Të drejtat e varietetit të bimës**

Varieteti i bimëve është një grupim i bimëve, i zgjedhur nga brenda një specie ose nën-specie, me një grup të përbashkët të karakteristikave. Larmia do të mbrohet duke dhënë të drejtën e seleksionuesit të bimëve. Varieteti i bimës mund të mbrohet nëse është i ri, i dallueshëm, uniform dhe stabil.

Ligji përkatës është Ligji Nr. 02/L-98 për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për varietetet e bimëve.

### **1.1.8. Topografia e prodhimit të gjysmëpërçuesve**

Topografia e qarkut të integruar - disponimi tre-dimensional, sado i shprehur, i elementeve, të paktën njëri prej të cilëve është element aktiv, dhe është i ndërlidhur në qarkun e integruar, ose pozicionimi tre-dimensional i përgatitur për një qark të integruar të destinuar për fabrikim.

Agjencia për PI lëshon të drejtat e regjistrimit dhe mbrojtjes së topografive në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-165.

### **1.1.9. Çertifikatat mbrojtjes plotësuese**

Çertifikatat e mbrojtjes plotësuese shërbejnë si zgjatje e të drejtave të patentës. Ato aplikohen për produkte specifike mjekësore dhe bimore. Sidoqoftë, ato nuk janë të aplikueshme në Kosovë.

### **1.1.10. Modelet e e dobishme**

Në shumë raste, kur një ndërmarrje thjesht e ka përmirësuar një produkt ekzistues dhe përmirësimi në fjalë nuk është mjaft shpikës për tu konsideruar i patentueshëm, modelet e e dobishme (ose “patentat e vogla” ose “inovacionet e shërbimeve”) mund jenë alternativë e mirë. Ato konsiderohen si ‘mini patentat’.

Sidoqoftë, modelet e e dobishme nuk janë të aplikueshme në Kosovë, ngjashëm me çertifikatat e mbrojtjes plotësuese.

### **1.1.11. Emrat tregtarë**

Emrat ose emërtimet e përdorura nga kompanitë për ta identifikuar veten dhe për t'i dalluar bizneset e tyre nga të tjerët në të njëjtën fushë konsiderohen si emra tregtarë.

Ligji Nr. 06/L-015 përfshinë edhe emrin tregtar në listën e të drejtave IP. Sidoqoftë në Kosovë emri tregtar nuk njihet si e drejtë ekskluzive e IP-së. Për këtë arsye asnjë ndërhyrje doganore nuk është e mundur për këto të drejta në kufirin e jashtëm të Kosovës.

## **1.2. LLOJET E SHKELJEVE TË MBULUARA**

Ligji Nr. 06/L-015 për Masat Doganore për mbrojtjen e DPI nuk ndikon në ligjin kombëtar për DPI; meqenëse përmban vetëm rregulla procedurale për autoritetet doganore, nuk përcakton ndonjë kriter për të konstatuar ekzistencën e një shkelje të DPI. Pyetja nëse një DPI është shkelur, është çështje e së drejtës materiale të pronës intelektuale.

### **1.2.1. Parimi**

Në parim masat doganore duhet të aplikohen nga Dogana e Kosovës në drejtim të mbrojtjes së DPI në lidhje me mallrat e falsifikuara, mallrat pirate dhe mallrat që dyshohet për shkelje të një DPI.

#### **Mallrat e falsifikuara**

Mallrat, përfshirë çdo paketim, etiketë, afishe, broshurë, udhëzime për përdorim, dokument garancie ose send të ngjashëm (edhe nëse paraqitet veçmas) që janë subjekt i një akti që shkelë një markë tregtare ose një tregues gjeografik.

#### **Mallrat pirate**

Mallrat që janë subjekt i një akti që shkelë të drejtën e autorit ose të drejtën e përafërt ose një dizajn industrial.

## **Mallrat e dyshuar për shkelje të një DPI**

Mallrat kur ka indikacione të arsyeshme se ato janë subjekt i një akti që shkelë një të drejtë të pronësisë intelektuale në Kosovë. Çdo kallëp ose matricë e cila është projektuar ose adaptuar posaçërisht për prodhimin e mallrave që shkelin një DPI konsiderohen gjithashtu si mallra të dyshuara për shkelje të DPI.

Mallrat e falsifikuara shkelin një markë tregtare dhe shpesh duken njësoj si mallra origjinale. Ato përmbajnë një simbol ose shenjë në produkt ose në paketim që duken identik me mallrat origjinale për të cilat është regjistruar marka tregtare, edhe pse ato nuk janë bërë nga pronari i asaj marke tregtare ose me pëlqimin e tij.

Mallrat pirate që kopjohen pa aprovimin e pronarit të së drejtës së autorit ose dizajnit. Mallrat e mirënjohura më të kopjuara janë CD dhe DVD që përmbajnë muzikë, filma ose videolojëra.

Mallrat që shkelin lloje tjera të të drejtave, si paisjet MP3 për muzikë, që shkelin patentat ose lulet dhe bimët që shkelin të drejtat e varietetit të bimës.

### **1.2.2. Përgjashtimet**

Procedurat e zbatimit nuk aplikohen për:

- Mallrat nën regjimin e përdorimit të fundit kur mallrat e tilla qëndrojnë nën mbikëqyrjen doganore,
- mallrat e natyrës jo komerciale në bagazhet personale të udhëtarëve.

Ligji Nr. 06/L-015 poashtu nuk aplikohet në rastin e mallrave të prodhuara me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës dhe për tepricat, përkatësisht mallrat e prodhuara nga një person i autorizuar nga një mbajtës i të drejtës për ta prodhuar një sasi të caktuar të mallrave, mbi sasi të dakorduara në mes të atij personi dhe mbajtësit të së drejtës. Sidoqoftë, sipas legjislacionit PI, Kosova miraton një regjim kombëtar të shterimit, kur mbajtësit e DPI kanë të drejtë t'i kundërshtojnë importet paralele, përveç nëse malli përkatës del në treg për herë të parë në Kosovë nga mbajtësi i të drejtave të pronësisë (direkt prej tij ose me pëlqimin e tij). Kjo do të thotë që mbajtësi i DPI-së e humb të drejtën

e tij të përjashtimit vetëm nëse malli shitet në treg në Kosovë. Nëse, në të kundërtën, hera e parë që malli vendoset në treg ndodh jashtë vendit, mbajtësi i DPI nuk i ka shteruar të drejtat e tij brenda shtetit që do të thotë se ai mund ta parandalojë importin paralel në Kosovë nga jashtë.

## **1.3. LËVIZJET E MALLRAVE TË MBULUARA**

### **1.3.1. Mbikëqyrja dhe kontrolli doganor**

Autoritetet doganore duhet të jenë të gatshme për t'i zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale në lidhje me mallrat, të cilat në përputhje me legjislacionin doganor të Kosovës, i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore ose kontrollit doganor, dhe për të kryer kontrole adekuate mbi këto mallra me qëllim që të parandalojnë operacionet e shkeljes së ligjeve për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale në kufi, kudo që janë mallrat, ose do duhej të ishin nën mbikëqyrjen doganore ose kontrollin doganor, është një mënyrë efikase për ta siguruar shpejt dhe në mënyrë efektive mbrojtjen ligjore të mbajtësit apo përdoruesit të së drejtës, dhe grupeve të prodhuesve.

### **1.3.2. Procedurat doganore**

Në veçanti autoritetet doganore duhet të jenë kompetentë për zbatim të DPI kur;

- 1-Mallrat deklarohen për qarkullim të lirë, eksport ose ri-import
- 2-Mallrat hyjnë ose dalin nga territori doganor i Kosovës
- 3-Mallrat vendosen nën;
  - 3.1. Procedurë të tranzitit
  - 3.2. Procedurë të depos doganore
  - 3.3. Procedurë të përpunimit të brendshëm
  - 3.4. Përpunim nën kontrollin doganor
  - 3.5. Import të përkohshëm
  - 3.6. Zonë të lirë ose depo të lirë doganore

## 2-APLIKIMI PËR VEPRIM

Zbatimi doganor i një DPI mund të kryhet vetëm kur personit që mban DPI i është miratuar aplikacioni për veprim (APV), duke kërkuar që të merren masa në lidhje me mallrat e dyshuara për shkelje të DPI. APV është rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-015 dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 53/2018.

### 2.1. PERSONAT QË KANË TË DREJTË TË KËRKOJNË VEPRIM DOGANOR

Një përshkrim i plotë i personave dhe subjekteve që kanë të drejtë të parashtrorjnjë AFA mund të gjendet në Nenin 4 të Ligjit Nr. 06/L-015 dhe përfshinë:

- Mbajtësit e të drejtës
- organet që administrojnë të drejtat kolektive të PI
- grupet e prodhuesve që administrojnë treguesit gjeografik, të cilët përfaqësojnë prodhuesit e produkteve me tregues gjeografik apo emërtim të origjinës; përfaqësuesit e këtyre grupeve dhe subjektet afariste që kanë të drejtë të përdorin një tregues gjeografik
- personat ose subjektet e autorizuar zyrtarisht nga mbajtësi i të drejtave për ta filluar procedurën, me qëllim që të përcaktojnë nëse është shkëlur një DPI.

### 2.2. FORMAT STANDARDE-PËRMBAJTJA E APLIKACIONIT

Aplikacioni për veprim doganor, që kërkohet nga Dogana për të ndërmarrë veprime në lidhje me mallrat e dyshimta për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale do të bëhet duke përdorur formularin në Aneksin I të Udhëzimit Administrativ Nr. 53/2018.

Fushat në formular të shënuara me yll (\*) janë fusha të detyrueshme dhe duhet të plotësohen.

Kur në një kuti, një ose më shumë fusha janë shënuar me shenjën plus (+), të paktën njëra nga ato fusha duhet të plotësohet.

Parashtruesi i kërkesës duhet të dorëzojë këto detaje:

- Emrin, adresën dhe detajet e kontaktit së bashku me statusin

e tij

- E drejta PI ose të drejtat për tu mbrojtur
- Provat e dokumentueshme që tregojnë se a i mban të drejtat përkatëse ose a janë të autorizuar të veprojnë në emër të bartësit të së drejtës
- Një përshkrim mjaft i hollësishëm i mallrave për t'ia mundësuar Doganës njohjen e mallrave
- Të dhëna teknike specifike për mallrat autentike, për shembull shënime, barkode dhe imazhe, sipas rastit
- Emri dhe detajet e kontaktit të ekspertëve ligjor dhe teknik
- Marrëveshjen se të dhënat e ofruara mund të përpunohen nga Dogana e Kosovës
- Nëse ai dëshiron të kërkojë shfrytëzimin e procedurës së “dërgesës së vogël” dhe pajtohet t’i mbulojë kostot e mallrave të shkatërruara në atë procedurë.

Parashtruesit të kërkesës do t’i kërkohej të kryejë këto veprime:

- Ta njoftojë Sektorin për Mbrojtjen e DPI kur një DPI nuk është në fuqi
- Përcjellë dhe përditësojë informatat që do ja mundësojnë autoriteteve doganore ta analizojnë dhe vlerësojnë riskun e shkeljes së PI
- Të merr përsipër përgjegjësi ndaj mbajtësit të mallrave kur, pas ndalimit:
  - (a) veprimi ndërpritet për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e parashtruesit të kërkesës
  - (b) mostrat ose nuk janë kthyer ose janë dëmtuar dhe janë përtej përdorimit për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e parashtruesit të kërkesës
  - (c) mallrat në fjalë zbulohet se nuk e shkelin një të drejtë IP
- të rimbursojë, kur kërkohej, kostot e bëra nga autoriteti doganorë ose personat e tjerë që veprojnë në emër të tyre, nga momenti i ndalimit.

Kur është e aplikueshme dhe nëse dihet, parashtruesi i kërkesës duhet të përfshijë gjithashtu brenda aplikacionit:



- Çdo informatë specifike në lidhje me llojin ose modelin e mashtrimit
- Portin ose shtetin nga i cili janë dërguar mallrat dhe porti i synuar i mbërritjes në Kosovë
- Datën e pritshme të mbërritjes ose nisjes së mallrave
- Detajet që identifikojnë dërgesën ose paketat: për shembull përshkrimet, shenjat dhe numrat, numri i kontejnerit, fletën rrugore ose detajet e manifestit
- Mjetet e transportit dhe identitetin e transportuesit, operatorit të logjistikës dhe/ose ndërmjetësit/agjentit doganor të përfshirë
- Identitetin (përfshirë adresën dhe kodin postar) të importuesit ose eksportuesit.
- Shtetin ose shtetet e prodhimit dhe rrugët e përdorura nga trafikantët
- Ndryshimet teknike, nëse dihen, në mes të mallrave autentike dhe atyre të dyshuara për shkelje

## 2.3. PARASHTRIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE PËR VEPRIM

Në Kosovë, APV parashtrohet pranë Sektorit për të Drejtat e Pronës Intelektuale të Doganës të Kosovës.

Aplikuesit nuk ngarkohen me tarifë për aplikimet e reja, ose kërkesat për zgjatje, të parashtruara sipas Ligjit Nr. 06/L-015. Sidoqoftë, Dogana e Kosovës rezervon të drejtën që t'ia kalojë parashtruesit të kërkesës çdo kosto që ata e shkaktojnë nga momenti i ndalimit duke përfshirë trajtimin, magazinimin dhe shkatërrimin e mallrave të dyshuara.

Periudha e vlefshmërisë së një APV nuk duhet ta kalojë një vit, por mund të zgjatet sipas kërkesës. Kur një APV dorëzohet në përgjigje të ndalimit sipas detyrës zyrtare, e cila nuk përmban të gjithë informatat e detyrueshme në lidhje me të dhënat teknike, etj. ajo aprovohet vetëm për periudhën e ndalimit të mallrave në fjalë, përveç nëse informata sigurohet brenda 10 ditëve pas njoftimit të pezullimit të lëshimit ose ndalimit të mallrave.

Dogana e Kosovës njofton parashtruesin e kërkesës për vendimin e saj për aprovimin ose refuzimin e kërkesës brenda 30 ditëve të punës nga marrja e kërkesës.

Nëse parashtuesi i kërkesës është njoftuar për pezullimin e lëshimit ose ndalimin e mallrave nga autoritetet doganore para parashtimit të kërkesës, Dogana e Kosovës njofton parashtuesin e kërkesës për vendimin e saj për aprovimin ose refuzimin e kërkesës brenda 2 ditëve të punës nga data e marrjes së kërkesës.

## **2.4. ZGJATJA E PERIUdhËS SË VLEFshmërisë SË KËRKESËS**

Kërkesa për zgjatjen e periudhës kohore gjatë së cilës Dogana e Kosovës i ndërmerr veprimet bëhet duke përdorur formularin në Aneksin II të Udhëzimit Administrativ Nr. 53/2018.

Për ta siguruar vazhdimësinë e mbulimit, rinovimi duhet të merret të paktën 30 ditë pune para skadimit të aplikimit dhe në çdo rast duhet të merret para datës së skadimit ose mund të kërkohet një APV e re.

## **2.5. NDRYSHIMET E VENDIMEVE PËR APROVIM TË KËRKESËS**

Dogana e Kosovës mund ta modifikojë listën e të drejtave të pronësisë intelektuale të aprovuara me vendimin e tyre me kërkesë të mbajtësit të vendimit.

## **2.6. PEZULLIMI OSE REVOKIMI I VENDIMEVE PËR APROVIM TË KËRKESËS**

Nëse një e drejtë PI pushon të ketë efekt, mbajtësi i vendimit duhet ta informojë autoritetin përkatës doganor në mënyrë që APV të ndryshohet ose revokohet. Në mënyrë të ngjashme, kur një parashtues i kërkesës pushon për ndonjë arsye ta ketë të drejtën për parashtim të AFA, ata duhet të informojnë autoritetin doganor përkatës; APV revokohet.

Dogana e Kosovës mund të revokojë dhe pezullojë vendimet që aprovjnë APV nëse mbajtësi i vendimit dështon të kthejë mostrat e mallrave të ndaluara, nuk njofton Doganat e Kosovës në lidhje me ndryshimet në të drejtat e PI të mbuluara me vendim, dështon të fillojë procedurat sipas nenit 23 të Ligji Nr. 06/L-015 dhe keqpërdorë informatat e dhëna nga Dogana e Kosovës në lidhje me deklaruesin.

## 3-PROCEDURAT E PARASHIKUARA NË LIGJIN Nr. 06/L-015

### 3.1. VEPRIMI DOGANOR

#### 3.1.1. Veprimi pas aplikimit

Kur dogana identifikon mallra për të cilat ka arsye të besojë se po shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale dhe të cilat mbulohen nga një aplikacion i vlefshëm, mallrat e dyshuar duhet të mbahen të ndaluara dhe Dogana duhet ta njoftojë deklaruesin ose mbajtësin e mallrave për ndalimin e tyre brenda 1 dite pune nga vendimi për ndalim dhe u jep atyre 10 ditë pune në të cilat ose pranojnë ose e kundërshtojnë braktisjen e tyre për shkatërrim.

Mbajtësi i vendimit gjithashtu duhet të njoftohet për ndalimin, në të njëjtën ditë ose menjëherë pas njoftimit për ndalim për deklaruesit ose mbajtësit e mallrave. Kjo shkresë e informon mbajtësin e vendimit se ka periudhën prej 10 ditë të punës në të cilën duhet të tregojë:

- Nëse mbajtësi i vendimit beson ose jo se mallrat shkelin ndonjë nga të drejtat PI të mbajtësit të vendimit,
- Kur besohet se mallrat shkelin një DPI, nëse mbajtësi i vendimit bie dakord për shkatërrimin e tyre.

Periudha e përgjigjes prej 10 ditë pune, dhënë deklaruesit ose mbajtësit të mallrave dhe mbajtësit të vendimit shkurtohet në 3 ditë pune në rastet e mallrave që prishen.<sup>2</sup>

#### 3.1.2. Veprimi sipas detyrës zyrtare

Kur mallrat e dyshuara për shkelje të një DPI zbulohen nga Dogana por nuk ka APV të vlefshme, atëherë procedura **sipas detyrës zyrtare** lejon ndalimin e mallrave të cilat dyshohen se shkelin një DPI. Sidoqoftë, kjo procedurë nuk aplikohet në rastin e mallrave që prishen.

Para ndalimit, Dogana mund të kërkojë ta identifikojë mbajtësin përkatës të së drejtës. Nëse asnjë mbajtës i së drejtës nuk është identifikuar brenda 1 dite, Dogana duhet t'i lëshojë mallrat; varësisht nga kompletimi i të gjitha formaliteteve tjera doganore. Nëse, identifikohet një mbajtës i së drejtës dhe ai shprehë dashjen për ta parashtruar një

<sup>2</sup>Mallrat që prishen janë mallra që konsiderohet se përkeqësohen nëse mbahen deri në 20 ditë nga data e pezullimit të lirit ose ndalimit nga Dogana e Kosovës

APV që mbulon ndonjë të drejtë IP që ai beson se është shkelur nga dërgesa, atëherë Dogana e ndalon mallin.

Dogana njofton deklaruesin ose mbajtësin e mallrave për ndalimin e tyre brenda 1 dite pune nga vendimi për ndalimin dhe u jep atyre 10 ditë pune në të cilat ose pranojnë ose e kundërshtojnë braktisjen e tyre për shkatërrim.

Njoftimi për ndalim gjithashtu duhet t'i jepet mbajtësit të së drejtës në lidhje me pretendimin e shkeljes së DPI, në të njëjtën ditë ose menjëherë pas njoftimit për ndalim deklaruesit ose mbajtësit të mallrave. Dogana i fton ata të parashtrojnë AFA që mbulon mallrat dhe të drejtën në fjalë dhe të konfirmojë nëse ata besojnë se mallrat shkelin ose jo dhe nëse po nëse bien dakord për shkatërrimin e tyre. Dogana i jep 10 ditë pune për përgjigje, por ata duhet të dërgojnë një AFA të pranueshme para fundit të 4 ditëve të punës.

Nëse AFA nuk është bërë brenda asaj periudhe, ose nëse kërkesa refuzohet, mallrat duhet të lirohen pas kompletimit të të gjitha formaliteteve doganore.

Procedurat që duhen ndjekur në rastet **sipas detyrës zyrtare** janë të njëjta me ato për rastet që bien në procedurën e thjeshtuar të shkatërrimit të përcaktuar në 3.2 të këtij manuali.

### **3.1.3. Veprimet pas parashtrimit dhe pranimit të Aplikimit për Veprim**

#### **Kontaktet paraprake me mbajtësin e vendimit para vendimit për ndalim ose pezullim të lëshimit të mallrave:**

Para se mallrat të ndalohen, nga mbajtësi i vendimit duhet të kërkohej të sigurojë çdo informatë relevante në lidhje me mallrat për të konstatuar nëse ka ndodhur ndonjë shkelje e DPI. Po kështu, Dogana mund t'i sigurojë mbajtësit të vendimit informatat në lidhje me sasinë aktuale ose të vlerësuar të mallrave, natyrën e tyre aktuale ose të supozuar dhe imazhet e tyre.

#### **Informatat që do t'i jepen mbajtësit të vendimit:**

Nëse kërkohej nga mbajtësi i vendimit, dhe nëse informata është e disponueshme, duhet të sigurohet me sa vijon:

- Emri dhe adresa e marrësit
- Dërguesi, dhe deklaruesi ose mbajtësi i mallrave
- Procedura e përfshirë doganore dhe,
- Origjina, prejardhja dhe destinacioni i mallrave të ndaluar.

Në rast të veprimit ex-officio, i vetmi informacion që mund t'i jepet ndonjë personi të tillë kur bën pyetje është sasia aktuale ose e vlerësuar e mallrave, natyra e tyre aktuale ose e supozuar ose imazhet e mallrave. Asgjë më tej nuk mund të zbulohet në këtë fazë që mund ta identifikojë deklaruesin, siç është emri i një individi ose kompanie. Kur të jetë aprovuar një AFA, mbajtësi i vendimit mund t'i kërkojë informatat e listuara më sipër, nëse janë në dispozicion.

## Inspektimi dhe marrja e mostrave të mallit

Dogana e Kosovës mund tu japë të gjitha palëve mundësinë për t'i inspektuar mallrat; në rastin e mallrave që dyshohet se janë të falsifikuara ose pirate, mbajtësi i vendimit mund të kërkojë mostër për analiza të mëtejshme. Kjo është në mënyrë rigorozë për qëllime të analizës dhe për ta lehtësuar çdo procedurë pasuese në lidhje me mallrat e falsifikuara ose pirate. Mbajtësi i vendimit është përgjegjës vetëm për ndonjë analizë të mostrave. Mostrat duhet të kthehen kur analiza të jetë kryer nga mbajtësi i vendimit.

## 3.2. PROCEDURA E THJESHTUAR E SHKATËRRIMIT

Mallrat mund të konsiderohen si të braktisura për shkatërrim në kushtet e mëposhtme:

- Mbajtësi i vendimit konfirmon me shkrim brenda periudhës së kërkuar që, sipas mendimit të tyre, mallrat shkelin një DPI dhe bien dakord për shkatërrimin e tyre **dhe**,
- Deklaruesi ose mbajtësi i mallrave jep konfirmimin me shkrim të marrëveshjes për shkatërrimin e tyre,

Dogana e Kosovës mund të gjykojë se është dhënë pëlqimi kur:

- Mbajtësi i vendimit konfirmon me shkrim se, sipas mendimit të tyre, mallrat shkelin një të drejtë IP të mbuluar nga APV dhe pajtohet me shkatërrimin **dhe**,
- Deklaruesi ose mbajtësi i mallrave nuk e ka konfirmuar marrëveshjen për shkatërrim dhe as nuk ka njoftuar kundërshtimin;

për shembull duke dështuar të përgjigjet brenda periudhës së përcaktuar.

Shkatërrimi kryhet nën kontrollin doganor dhe nën përgjegjësinë e mbajtësit të vendimit. Afati i ndalimit është 10 ditë pune nga njoftimi për ndalim. Në rastin e mallrave që prishen, kjo shkurtohet në 3 ditë pune.

Nëse deklaruesi ose mbajtësi i mallrave kundërshton shkatërrimin e tyre ose, në mungesë të kundërshtimit, Dogana e Kosovës ka zgjedhur që mos të gjykojë se është dhënë pëlqimi; Dogana e Kosovës do ta njoftojë mbajtësin e vendimit në përputhje me rrethanat. Pastaj është e hapur për mbajtësin e vendimit për t'i filluar procedurat ligjore për të konstatuar nëse një DPI është shkelur. Nëse mbajtësi i vendimit nuk ka dorëzuar kopje të padisë së parashtruar pranë gjykatës kompetente për të vendosur nëse një DPI është shkelur pranë Doganës së Kosovës që ata kanë iniciuar procedurat për të konstatuar nëse e DPI e tyre është shkelur para periudhës së ndalimit, përfshirë çdo zgjatje, mallrat duhet të lirohen nga ndalimi; varësisht kompletimit të të gjitha formaliteteve tjera doganore.

Me përjashtim të rasteve të mallrave që prishen, Dogana mundet, me kërkesë të mbajtësit të vendimit dhe kur bien dakord se është e arsyeshme, ta zgjatë periudhën e ndalimit për maksimum prej 10 ditëve tjera të punës. Periudha totale nuk mund t'i kalojë 20 ditë pune.

### 3.3. PROCEDURA E THJESHTUAR E SHKATËRRIMIT PËR DËRGESA TË VOGLA

Ligji Nr. 06/L-015 krijon një procedurë opsionale përmes të cilës mallrat në ngarkesa të vogla mund të braktisen për shkatërrim me shpenzime të mbajtësit të vendimit pa ndonjë referencë tek mbajtësi i vendimit ose nevojën që mbajtësi i vendimit t'i nisë procedurat ligjore. Dërgesa e vogël përkufizohet nga Doganat e Kosovës si një dërgesë postare ose përmes korrierit të shpejtë e cila:

- Përmban tre njësi ose më pak, **ose**
- Ka një peshë bruto më pak se 2 kilogramë.

Procedura e thjeshtuar e shkatërrimit për dërgesat e vogla aplikohet vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Mallrat në dërgesë dyshohet të jenë të falsifikuara ose pirate
- Mallrat nuk prishen
- Ekziston tashmë një APV që mbulon mallrat në fjalë dhe,
- Mbajtësi i vendimit ka kërkuar përdorimin e procedurës së thjeshtuar të shkatërrimit për dërgesat e vogla kur ata parashtrojnë APV -në e tyre.

Kur mallrat në ngarkesë të vogël të cilat dyshohet se shkelin një DPI zbulohen në kufi, ato duhet të mbahen të ndaluara dhe deklaruesit ose mbajtësit të mallrave duhet t'i jepet njoftimi për ndalim. Kjo shkresë duhet të lëshohet brenda 1 dite pune nga ndalimi.

### **Mbajtësi i vendimit nuk njoftohet për ndalimin në këtë fazë.**

Deklaruesi ose mbajtësi i mallrave ka 10 ditë pune nga data e njoftimit për të dhënë përgjigje duke treguar njërin nga këto dokumente:

1) Marrëveshjen për shkatërrimin e mallrave, ose 2) Kundërshtimin për shkatërrimin e tyre.

Nëse marrësi i njoftimit të ndalimit përgjigjet brenda periudhës së specifikuar në njoftim, duke treguar pajtimin për shkatërrimin e tyre, shkatërrimi kryhet nën kontrollin doganor.

Nëse nuk merret përgjigje brenda kohës së specifikuar, mund të konsiderohet se është dhënë pajtimi për shkatërrimin, dhe rregullimet për shkatërrim duhet të vazhdojnë në përputhje me rrethanat.

Nëse deklaruesi ose mbajtësi i mallrave e ka njoftuar kundërshtimin e tij për shkatërrim ose, në mungesë të kundërshtimit, Dogana e Kosovës nuk ka gjykuar se është dhënë pëlqimi; mbajtësit të vendimit duhet t'i jepet mundësia që t'i nisë procedurat për ta mbrojtur të drejtën e tij të IP.

Mbajtësi i vendimit ka 10 ditë pune nga ai njoftim në të cilin duhet ta kontaktojë Doganën e Kosovës duke kërkuar konfirmimin nëse procedurat janë iniciuar. Nuk është e mundur të zgjatet kjo periudhë.

Dogana e Kosovës, sipas kërkesës dhe kur informata është në dispozicion, i jep mbajtësit të vendimit informatat për sasinë aktuale ose të përlogaritur të mallrave të shkatërruara dhe natyrën e tyre.

Nëse me skadimin e afatit, Dogana e Kosovës nuk ka marrë ndonjë kopje të padisë të parashtruar pranë gjykatës kompetente, atëherë mallrat **duhet** të lirohen; varësisht nga kompletimi i të gjitha formaliteteve tjera doganore.

Mallrat që do të shkatërrohen si në procedurë të rregullt të thjeshtuar ashtu edhe në procedurë të thjeshtuar për ngarkesat e vogla nuk janë:

- Lëshuar për qarkullim të lirë;
- Dalë jashtë territorit doganor të Kosovës;
- Eksportuar;
- Ri-eksportuar;
- Vendosur nën ndonjë procedurë pezullimi;
- Vendosur në ndonjë zonë të lirë ose depo të lirë.

## **4- DETYRIMET DHE KOSTOT**

### **4.1. DETYRIMET E DOGANËS SË KOSOVËS**

Dhënia e një APV nuk i jep të drejtë mbajtësit të vendimit në fjalë për kompensim në rast se mallrat e dyshuara për shkelje të një të drejte IP nuk detektohen dhe lëshohen ose nuk ndërmerren masa për ndalimin e tyre.

### **4.2. DETYRIMET E MBAJTËSIT TË VENDIMIT**

Mbajtësi i vendimit i detyrohet mbajtësit të mallit ose deklaruesit kur pas ndalimit:

- Veprimi ndërpritet për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e mbajtësit të vendimit
- Mostrat ose nuk janë kthyer ose janë dëmtuar dhe janë përtej përdorimit për shkak të një veprimi ose mosveprimi nga ana e mbajtësit të vendimit
- Zbulohet se mallrat në fjalë nuk e shkelin një DPI

Për më tepër, nëse mbajtësi i vendimit nuk i inicion procedurat nën procedurën e thjeshtuar të shkatërrimit, Dogana e Kosovës mund të vendosë të mos veprojë sipas vendimit që aprovon një APV dhe mbajtësi i vendimit nuk do të jetë në gjendje të parashtojë kërkesë të re



për të njëjtën DPI brenda 1 viti.

### **4.3. DETYRIMI PËR KOSTOT**

Duke pasur parasysh se autoritetet doganore ndërmarrin veprime pas aplikimit, është e përshtatshme të parashikohet që mbajtësi i vendimit të rimbursojë të gjitha kostot, përfshirë kostot e magazinimit, trajtimit dhe shkatërrimit të shkaktuara nga autoritetet doganore në marrjen e masave për t'i përmbaruar të drejtat e tij të pronës intelektuale. Sidoqoftë, kjo nuk duhet ta pengojë mbajtësin e vendimit nga parashtrimi i kërkesës për kompensim nga shkelësi ose personat tjerë që mund të konsiderohen përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi.

Mbajtësi i vendimit është gjithashtu përgjegjës për kostot për ndonjë përkthim që kërkohet nga Dogana e Kosovës në lidhje me mallrat e dyshuara.

## **5- ÇËSHTJET TJERA QË LIDHEN ME PROCEDURAT E ZBATIMIT**

### **5.1. LIRIMI I HERSHËM I MALLRAVE**

Kur një mbajtës i vendimit t'i ketë iniciuar procedurat për të konstatuar nëse një e drejtë e dizajnit industrial, patentë, topografi e produktit gjysmëpërçues, model i dobishëm ose e drejtë e varietetit të bimës është shkelur, deklaruesi ose mbajtësi i mallrave mund të kërkojë lirimin e tyre nga ndalimi para kompletimit të procedurës.

Lirimi do të lejohet vetëm kur:

- Të jetë siguruar një garanci e mjaftueshme bankare nga deklaruesi ose mbajtësi i mallrave,
- Nuk është vendosur ndonjë masë paraprake nga gjykata,
- Janë përmbushur të gjitha formalitetet doganore.

### **5.2. TREGUESIT E RISKUT PËR SHKELJE TË PRONËS INTELEKTUALE**

Risku është mundësia që zbatimi i kontrolleve të ndikohet negativisht. Analiza e riskut synon të fokusojë kontrollet në fushat me risk më të lartë duke lënë në të njëjtën kohë pjesën më të madhe të tregtisë të kalojë relativisht lirshëm përmes doganës. Treguesit e riskut janë ata faktorë që mund të rrisin ose ulin nivelin ose shkallën e riskut për funksionin e zbatimit të DPI.

### **5.2.1.Treguesit e Riskut të Bazuar në Dokumente**

Shqyrtimi i dokumenteve dhe informatave elektronike të parashtruara nga dërguesi, marrësi, importuesi ose përfaqësuesi i tyre ndihmojnë zyrtarët doganorë të identifikojnë mallrat që paraqesin risk të lartë kundër falsifikimit dhe piraterisë.

#### **- Përshkrimi i mallrave/mallrave me risk**

Dhënja e deklaratave të rreme ose përshkrimet e paqarta të artikujve është një nga metodat e përdorura nga ata që merren me pirateri dhe falsifikim.

Mallrat luksoze, artikujt e dizajnerëve dhe artikujt e popullarizuara ose trendi, bartin riskun më të lartë për falsifikim (sidomos të markave të mirënjohura) dhe pirateri.

Rrobat dhe aksesorët: orët dhe pjesët e tyre; çantat, kuletat, çantat e shpinës etj. regjistrimet zanore, mediat e lëvizshme të regjistruara, përfshirë imazhet dhe programet kompjuterike (veçanërisht disqe optike); cigaret; birrat, vera dhe pijet alkoolike; lodrat dhe videolojërat; aksesorët dhe harduerët kompjuterik; syzet e diellit; kapelat; këpucat; sendet elektronike; pjesët rezervë të automobilave dhe avionëve dhe ilaçet mund të përkufizohen si mallra me risk për falsifikim dhe pirateri në përgjithësi.

#### **- Përshkrimi i paqartë i mallrave**

Mallrat e përshkruara me shprehje dykuptimëshe si “bosh”, “të papërfunduar”, “mallra plastike”, “veshje plastike”, “metale”, “veshje metal”, “disqe metal”, “mostra”, “mjete shtëpiake” shpesh kanë risk të lartë të falsifikimit dhe piraterisë.

#### **- Vendi i origjinës i njohur si burim i mallrave të falsifikuara ose pirate**

Mallrat me origjinë nga shtetet e njohura si burim i mallrave të falsifikuara ose pirate paraqesin risk për falsifikim dhe pirateri.

Sipas raportit DPI të BE 2018, për shtetet e prejardhjes në lidhje me

vlerën, Kina është në krye të listës, e ndjekur nga Hong Kong, Turqia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe si në vitet e mëhershme. Vietnami, Kamboxhia dhe Bangladeshi janë në shtatë vendet e para.

Mallrat që hyjnë përmes kufirit tokësor ose mallrat që kalojnë përmes një shteti që dihet se është i dobët në mbrojtjen e DPI paraqesin gjithashtu risk për falsifikim.

Zonat e lira shpesh përdoren si pika të shpërndarjes për mallrat e falsifikuara dhe pirate. Këto mallra ose vijnë nga shtetet ku prodhohen produkte imituese dhe të falsifikuara, ose prodhohen në zonën e lirë.

### **- Shteti i destinacionit ka një reputacion të kërkësës për mallra të falsifikuara ose pirate**

Jo vetëm kur mallrat importohen, por edhe tranzitet, apo (ri)eksportet me një shtet të destinacionit final i cili ka reputacion të kërkësës për mallra të falsifikuara ose pirate, bëhet tregues i riskut për falsifikim ose pirateri.

### **- Natyra dhe cilësia e dokumenteve**

Printime të pazakonta të dëftesave të ngarkesës dhe të faturave, cilësia e dobët e printimit, faturat e shkruara me dorë ose faturat e ngarkimit të shkruara me dorë, paraqesin risk. Normalisht, faturat gjenerohen në mënyrë elektronike dhe shpesh printohen në letër speciale me logon ose adresën e kompanisë të para-shtypura. Ndryshimet në dokumente, shprehjet e fshira ose korrigjime tjera, faturat ose dëftesat e ngarkimit jo të plota mund të konstatohen si tregues të riskut për DPI.

Shumë dokumente ligjore përmbajnë:

- Numri i telefonit/faksit, adresa e postës elektronike, numrat e regjistrimit të biznesit të transportuesit, importuesit ose prodhuesit të mallrave;
- Deklaratat e shitjeve dhe dorëzimit; FAS (falas anash), FOB (falas në bord), Net 30 (pagesa brenda 30 ditëve);
- Numri i porosisë ose numri i faturës dhe data (bota e biznesit përdor fatura me numra në formë serike);
- Zbritje në pagesën e faturave ligjore (p.sh. 2% zbritje nëse paguhet brenda 30 ditëve);
- Mungesa e faturave dhe dëftesave të ngarkimit gjithashtu mund të tregojnë risk të lartë;
- Importuesit, pronarët ose blerësit e mallrave të falsifikuara zakonisht përpiqen të mos përdorin deklaratën doganore elektronike dhe sistemet tjera.

## **- Emri dhe Adresa e Prodhuesit/Dërguesit dhe Importuesit/ Marrësit**

- Importuesi ka pak ose aspak histori importi, ka shkelje penale doganore të regjistruar
- Emri i prodhuesit, dërguesit ose importuesit duket se është fiktiv.
- Emri i prodhuesit, transportuesit ose importuesit nuk përputhet me tregtarin e mallrave të deklaruar. Në përgjithësi, nëse ka marrëdhënie në mes të importuesit, pronarit ose marrësit dhe eksportuesit ose transportuesit të mallrave, kjo do të thotë risk më i ulët në aspektin e DPI.
- Adresa e prodhuesit, transportuesit ose importuesit mungon ose nuk mund të verifikohet përmes librave telefonik, internetit ose burimeve të ngjashme të hapura.
- Prodhuesi, transportuesi ose importuesi përdorë një kuti postare ose adresë elektronike ose marrësi njihet vetëm me numrin e telefonit (telefonit celular).
- Adresat e prodhuesit, transportuesit ose importuesit që i përkasin një rajoni të famshëm për prodhimin e mallrave të falsifikuara dhe pirate.

## **- Vendi i prodhimit**

Nëse shteti i deklaruar i origjinës është një shtet ku mbajtësi i të drejtës nuk mundëson prodhimin, kjo tregon se mallrat mund të jenë të falsifikuara ose pirate (megjithatë, mallrat nga një shtet jo-prodhues mund të jenë edhe mallra të importeve paralele).

Pjesët ose materialet që përmbajnë emrin ose markën e një mbajtësi të së drejtës të cilat dërgohen në një shtet jo-prodhues, mund të jenë të falsifikuara ose pirate.

Për shembull, orët origjinale Rolex prodhohen ekskluzivisht në Zvicër. Orët e markës Rolex që vijnë nga një shtet tjetër përveç Zvicrës janë të diskutueshme.

## **- Rrugëtimi i mallrave dhe mjeteve të transportit**

- Mallrat që mbërrijnë në port përveç kanaleve të zakonshme të shpërndarjes të mbajtësit të së drejtës.
- Përdorimi i rrugëve ose distribucionit që është i ndryshëm nga

ai i përcaktuar nga mbajtësi i së drejtës. (ndërsa kjo ngrit dyshim se mallrat mund jenë të falsifikuara, gjithashtu tregon që mallrat mund t'i nënshtrohen importit paralel.)

- Përdorimi i një rruge të paarsyeshme në dërgesën e mallrave (trans-ngarkimi) ose prania e kostove të transportit në mënyrë proporcionale të lartë.

#### **-Vlera e deklaruar e mallit**

- Vlera e deklaruar jashtëzakonisht e lartë ose e ulët
- Mallrat me sigurim por me vlerë shumë të ulët.
- Nëse vlera e deklaruar doganore (brenda kornizës së Mar-rëveshjes për Vlerën e OBT) përfshin taksa, licenca ose pagesa për të drejtat e tjera të pronësisë, kjo do të thotë më pak risk për falsifikim dhe pirateri.
- Mallrat që faturohen si “Refuz” ose mallrat që faturohen sipas peshës e jo sasisë. Për shembull; CD-të e faturuara për kilogramë e jo copë.

#### **- Madhësia e dërgesës**

Dorëzimi i sasive jashtëzakonisht të larta ose të ulëta të mallrave në varësi të llojit të mallrave. Për shembull, një dërgesë prej 20,000 orë Rolex është jashtëzakonisht e madhe.

#### **- Kushtet e shitjes/dorëzimit**

- Kushtet e shitjes në formën e “Para të gatshme” ose “COD” (Paratë me rastin e dorëzimit)
- Afati i transportit në formën e “EXW” (Ish-punët)
- Dërgesat e parapaguara përfshijnë risk.

### **5.2.2. Indikatorët e riskut bazuar në paketim**

Gjatë shkarkimit të mallrave, kontrolli i paketimit ose kontrollimi i hapësirave të magazinimit dhe depove, gjithashtu mund tu ndihmojnë zyrtarëve doganorë që të dallojnë mallra që paraqesin risk të lartë për falsifikim. Në përgjithësi, mbajtësit e të drejtave përdorin material paketimi me cilësi të lartë dhe e paketojnë mallin mjeshtërisht. Mallrat pakëtohen individualisht dhe vendosen në kuti të qëndrueshme të etiketuara me numrin e njësisë, barkodet dhe sasi të.

#### **- Dukja e paketimit**

- Mallrat e paketuara në një mënyrë që nuk përputhet me atë që përdor mbajtësi i së drejtës. (mbështjellja e tërë mallit me plastikë transparente, dërgimi i CD-ve në një kuti me shumë CD e jo në kutitë e tyre speciale që përdoren për shitje me pakicë, pa titull të CD-ve, dhe pa emër të artistit në kuti)
- Nëse dukja (madhësia apo forma) e paketimit të mallrave nuk është standarde. (Për shembull, orët e paketuara në qese plastike ose transparente)
- Cilësia e paketimit, shenjat ose markat në paketim janë të dobëta. (Gabime drejtshkrimore)

Për shembull, orët me cilësi të lartë transportohen normalisht në kuti prej druri. Këpucët origjinale futen në kuti në çifte dhe vendosen në kuti kartoni më të mëdha. Rrobat dhe aksesoret zakonisht pakëtohen në qese plastike me cilësi të lartë me frymëmarrje, me paralajmërime të shtypura në gjuhë të ndryshme dhe të vendosura mbi kuti.

### **5.2.3. Treguesit e Riskut Bazuar në Mallra**

#### **- Cilësia e mallrave**

- Mallra me cilësi të dobët që nuk përshtaten me reputacionin e mbajtësit të së drejtës.
- Mallrat e dërguara pa udhëzime, garanci ose dokumente sigurimi, printim me cilësi të ulët ose udhëzime të fotokopjuara për përdorim, garanci ose dokumente sigurimi.
- Etiketat, udhëzimet ose dokumentet e sigurimit të mallrave nuk janë të përkthyer ose përmbajnë gabime tipografike.

## - Etiketat dhe shenjat mbi mallra

- Mungojnë numrat e pjesëve, barkodet, datat e skadimit ose shenjat tjera standarde, siç janë vendi ose data e prodhimit. Etiketat e produkteve përfshijnë në përgjithësi numrin e produktit, numrin e referencës ose katalogut, informatat e objektit ose fabrikës, numrin serik ose modelin.
- Mallrat që bartin tregues gjeografik, përcaktimin e origjinës së burimit, vendin ose rajonin që nuk ndodhet në shtetin e prodhimit ose eksportit.
- Mungojnë shenjat e markës tregtare ose të drejtës së autorit, ose janë të paplota njoftimet e markës tregtare ose të drejtës së autorit (® për markën tregtare të regjistruar, © për të drejtën e autorit).
- Etiketat dhe markat që nuk përputhen me ligjet e shtetit të importit ose standardet tjera rregullatore. (p.sh. tekstilet, përmbajtja e tyre ose udhëzimet e pastrimit nuk janë specifikuar; mallrat, shteti i origjinës nuk është specifikuar saktë; ushqimet ose kozmetika pa listën e përbërësve).
- Mallrat dhe etiketat që nuk përputhen me etiketat dhe mallrat e prodhuara nga mbajtësi i së drejtës (p.sh. orët e prodhuara në Zvicër nuk duhet të shënohen me “Made in Japan” ose “Made in China”)

## - Detajet e produktit

Mbajtësit e të drejtave shpesh u bashkangjesin detaje të fshehta ose tjera produkteve të tyre për ta lehtësuar identifikimin e mallrave të falsifikuara. Në raste të tilla, është mirë ta përdorni broshurën e përshkrimit të produktit të dhënë nga mbajtësi i së drejtës ose ta kontaktoni direkt mbajtësin e të drejtës.

Shumë mbajtës të të drejtave përdorin detaje të vështira për tu prodhuar, siç janë hologramet, për ta dokumentuar saktësinë dhe vërtetësinë e produkteve të tyre. Disqet optike reale (CD, CDRom, DVD) mbajnë një kod të quajtur SID. (SID: Burimi i Kodit të Identifikimit) Dokumentet e garancisë që shoqërojnë orët me cilësi të lartë mbajnë karakteristika të veçanta identifikimi si shenja uji ose pulla të ftohta.

## - Markat tregtare të shumëfishta në një ngarkesë

Dërgesat që përmbajnë mallra të prodhuara nga një numër i madh i mbajtësve të markave tregtare. Për shembull, softuer kompjuterik i prodhuar nga kompani të ndryshme brenda të njëjtës dërgesë, filma

të prodhuar nga studio të ndryshme, ose regjistrime zanore të prodhuara nën etiketa të ndryshme.

Një dërgesë që përmban shumë brende të ndryshme të çantave ose një dërgesë që përmban brende të ndryshme të orëve që nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën.

### 5.3. MJETET E DISPONUESHME NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË DPI

Për tu ndihmuar autoriteteve me kompetencë për zbatim që t'i kuptojnë më mirë mjetet e disponueshme në trajtimin e rasteve të DPI në punën e tyre të përditshme, organizata të shumta ofrojnë një seri udhëzimesh si dhe qasje në burime bazike. Këtu do ta gjeni një listë të mjeteve dhe databazave të zhvilluara për të përkrahur zbatimin:

- [Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale \(WIPO\) Gold WIPO GOLD ofron një portë ku mund të kërkohen informata globale të koleksionuara nga WIPO, Databaza globale e markave WIPO, WIPO PATENTSCOPE, databaza globale e dizajnit të WIPO, WIPO Lex janë burim](#)
- [Databaza e Zyrës Evropiane të Patentave - Databaza Evropiane e Zyrës së Patentave jep qasje falas në më shumë se 70 milion dokumente të patentave në tërë botën, dhe përmban informata rreth shpikjeve dhe zhvillimeve teknike nga 1836 deri më sot.](#)
- [Unioni Tatimor dhe Doganor i Komisionit Evropian \(DG TAXUD\) Indikacionet e siguruara nga Unioni i Taksave dhe Doganave mund të ndihmojnë në identifikimin e falsifikimeve dhe mallrave tjera që shkelin DPI.](#)
- [Kolegji Ndërkombëtar i Hetuesve të Krimin të Pronës Intelektuale \(IIPCIC\) është një strukturë trajnimi plotësisht interaktive në internet që synon t'i pajisë përmbartuesit me aftësitë e nevojshme për ta luftuar në mënyrë efektive krimin e organizuar ndërkombëtar të IP. Të gjithë hetuesit e krimin IP duke përfshirë policinë, zyrtarët e doganave dhe përfaqësuesit përkatës të institucionit rregullator mund të trajnohen pa pagesë. Seria e trajnimeve në internet për zbatimin e të Drejtave të Pronës Intelektuale për Zyrtarët e Doganave është zhvilluar dhe mirëmbahet nga Kolegji Ndërkombëtar i Hetuesve të Krimin të Pronës Intelektuale \(IIPCIC\) me ndihmën e Organizatës Botërore të Doganave \(OBD\).](#)





# IPRproject

Intellectual Property Rights Project

Rr. "Johan V. Hahn",  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 726 688

 IPRKosovo